



WATER AND WASTE REGULATORY OFFICE
ZYRA RREGULLATORE PËR UJË DHE MBETURINA
REGULATORNI URED ZA VODU I OTPAD

VËREJTJET HYRËSE TË AFRIM LAJÇIT, DREJTOR I ZRRUM-IT, NË WORKSHOPIN KONSULTATIV PËR TARIFA

E MËRKURË, 12 DHJETOR 2007

-
- Përcaktimi i tarifave është **aktivitet qendror** i procesit rregullator që e zbaton ZRRUM, prandaj është në fokus të angazhimeve tona. Qëllimi imi dhe i ZRRUM-it është që të zhvillojmë një proces tarifor që është eficient dhe efektiv i cili proces i siguron zyrës sonë të dhëna cilësore dhe në afat në bazë të cilave mund të mirren vendime për tarifa.
 - Workshopi i sotëm është një **aktivitet i rëndësishëm konsultativ**. Ne dëshirojmë që ju të dëgjoni me vëmendje prezentimet tona dhe që pastaj të dëgjojmë pikëpamjet e juaj lidhur me propozimet e bëra. Kalendari që e kemi përcaktuar për zbatimin e ndryshimeve të propozuara mundëson që ju të jepni komentet e juaj edhe vitin tjetër dhe pastaj ne ti shqyrtojmë ato komente me kujdes para se ta finalizojmë dhe ta zbatojmë qasjen tonë.
 - Ky **NUK është një regjim i ri tarifor**. Në fakt, është një zhvillim i rëndësishëm i regjimit ekzistues të përcaktimit të tarifave prandaj si i tillë nuk do të duhej të paraqes një sfidë të paarsyeshme për kompanitë – me kusht ju të kuptoni në tërësi qëllimin dhe metodologjinë e propozuar.
 - Dua të theksoj se ndryshimet e propozuara të regjimit tarifor janë shumë të rëndësishme. Prandaj duhet të kuptohen seriozisht nga të gjithë. **Rregullativa ekonomike nuk është e përkohshme**. Drafti i Ligjit të ri të ZRRUM-it që duhet të aprovohet nga Parlamenti i ri në fillim të vitit të ardhshëm do ta përforcojë këtë fakt. ZRRUM vepron dhe do të vazhdojë të veprojë brenda kuadrit ligjor të definuar qartë.
 - Ne vazhdimisht do të kërkojmë mënyrat për të përmirësuar procesin rregullator. Në të njëjtën kohë ne do të presim nga ju që të gjeni mënyrën për të përmirësuar **shërbimet e juaja ndaj konsumatorëve**. Angazhimet e kompanive lidhur me nevojat e konsumatorëve aktualisht nuk janë në nivelin e dëshiruar p.sh. ofrimi i mundësive për tu ankuar për shërbimet jociësore.

- Propozimi që e prezentojmë sot paraqet një **evoluim stabil** të qasjes sonë lidhur me përcaktimin e tarifave. Nuk ka kuptim që të ndryshohet shpesh drejtimi – ne dëshirojmë që përmirësimet të bëhen në bazë të përvojave tona dhe në frymën e praktikave të mira të vendeve të zhvilluara ashtuqë mos të këtë ndryshime të papritura dhe radikale.
- Procesi i fundit tarifor që është zhvilluar sivjet ka nxjerrë në pah disa çështje të cilat do të diskutohen në pjesën e parë të workshopit. Nga ky proces janë nxjerrë disa mësimë duke përfshi edhe dobësitë në modelin aktual tarifor të ZRRUM-it. Propozimi ynë sot **merr parasysh këto mësimë të nxjerra** nga procesi i kaluar.
- Cilat janë elementet kyçe të ndryshimeve të propozuara të regjimit tarifor?
 - **Kalendari rregullator** që përcakton një orar të qartë të aktiviteteve specifike përfshirë edhe afatet për dorëzimin e të dhënave nga kompanitë
 - Theksi në **përgatitjen e Planeve të Biznesit** nga kompanitë me instruksione të qarta nga ne për atë se çfarë duhet të jetë përmbajtja e tyre
 - Planet e Biznesit duhet të fokusohen në: investimet kapitale, mirëmbajtjen kapitale, rehabilitimin e sistemit, dhe planet e kompanive si do të ngrisin inkasimin dhe si do të reduktojnë kostot operative.
 - Në mënyrë të veçantë ZRRUM do të involvohet në hartimin e Planeve të Biznesit me qëllim që të dakordohen caqet sa i përket treguesve kyq të performansës siq janë: shkalla e inkasimit dhe humbjet e ujit dhe të dijë hollësitë se si kompanitë planifikojnë ti përmirësojnë këta tregues.
 - Ne poashtu do të zhvillojmë qasjen e Planit të Menaxhimit të Aseteve për investimet në asetet nëntokësore.

Dua të theksoj se disa prej koncepteve të cilat do ti prezantojë Keith Burwell janë komplekse. Prandaj, ky workshop ju jep mundësinë për të parashtruar pyetje për këto koncepte. Nëse edhe pas këtij workshopi keni nevojë për ndonjë sqarim ju lutem kontaktoni Zyrën tonë. Ne jemi këtu për të ndihmuar.

Në fund, cilat janë përfitimet për kompanitë?

- Qëndrueshmëria dukshwëm e përmirwsuar financiare
- Konfidenca e investitorëve (donatorëve dhe kreditorëve)

Jam i bindur se ndryshimet e propozuara do të na ndihmojnë të arrijmë aspiratat tona për **kompani financiarisht stabile** që ofrojnë **shërbime më të mira për konsumatorët**.